VENDIM
Nr. 89, datë 31.5.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 4, pika 11, 12, 50; nenit 22, pika 2, germa "c"; nenit 75, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "c"; nenit 5; nenit 8, nenit 9, pika 1, germa "a", "b", "c", "d," "e"; pika 2, germa "f"; dhe nenit 10, pika 1, të "Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2019 nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, lidhur me fillimin e procedurave për Licencimin e shoqërisë "Albpetrol" sh.a., në aktivitetin e Furnizimit të Gazit Natyror",

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 348 prot., datë 16.5.2019, shoqëria "Albpetrol" sh.a., ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të aplikimit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a. në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", rezulton se:

- Neni 9, pika 1, "Format dhe dokumentacioni për aplikim":
- germa "a" "b" "c", janë plotësuar.
- germa "d" "Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor",
- pikat:
i. është plotësuar;
ii. është e pa plotësuar;
iii. pa plotësuar;
vi. është e pa plotësuar.
- Germa "e". Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale,
- pikat:
i. është e pa plotësuar.
ii. është e plotësuar pjesërisht
iii. është i pa plotësuar.
iv. është e pa plotësuar.
v. është e pa plotësuar.
- Neni 9, pika 2 "dokumente specifike për llojin e licencës"
- Germa "f", pikat:
i. është e pa plotësuar
ii. është plotësuar
iii. është plotësuar

Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet subjekti që në bazë të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transmetimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave për sektorin e gazit natyror", t'i paraqesë në ERE, këto dokumente brenda afatit të caktuar.

- Neni 23, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror"", i ndryshuar, parashikon se: ERE përcakton afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili, për veprimtaritë e transmetimit, të shpërndarjes, të depozitimit dhe të GNL-së, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet dhe për veprimtaritë e tjera nuk mund të jetë më shumë se 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje;

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Albpetrol" sh.a., në aktivitetin e Furnizimit të Gazit Natyror, për një afat 10-vjeçar.

2.rejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti